



Npi – 01/123 datë: 03.04.2025

Duke u bazuar në nenin 40.2 shkronja (b dhe c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008); Nenin 58.3 të Ligjit, për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë Nr.03/L-048; Neni 27 i Ligjit Nr.08/L-193 mbi Ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024; Nenin 2.3, dhe nenin 7.1 shkronja (i), dhe nenin 8 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal Nr.03/L-049; Si dhe mbi bazën e prezantimit të Propozim-Vendimit Nr.11/44 dt.28.03.2025 për bartjen e të hyrave nga viti 2024 në vitin 2025 nga Drejtoria Komunale për Buxhet dhe Financa, Kuvendi i Komunës së Shtimes, në seancën e mbajtur më 03.04.2025, miratoi këtë:

V E N D I M

PËR APROVIMIN E BARTJES SË TË HYRAVE VETANAKE NGA VITI 2024 NË VITIN 2025

I

Kuvendi i Komunës së Shtimes në Seancën e -III- të rregullt për vitin 2025, të mbajtur më: 03.04.2025, unanimisht miratoi Vendimin për bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2024 në vitin 2025, sipas tabelës në vijim:

Nr.	Ko di i OB	Kodi Ekono mik	Kodi i propozuar i programit për vitin 2024	Kodi i projektit në vitin 2025	Programi Buxhetor	Emërtimi i projektit	Ndryshimi i propozuar për vitin 2025 në €
1	617	20	160(16007)		Zyra e Kryetarit	Subvencione dhe Transfere	2,000.00
2		30	660(66340)	55132	Planifikim Urban, Mjedisi dhe Inspeksion	Rregullimi i rrugëve dhe trotoareve: Rr.Ulqini seg.-I- Rr.Jashari. Vazhdim i trotuarit në Muzeqinë	7,988.13
3		30	660(66340)	55149	Planifikim Urban, Mjedisi dhe Inspeksion	Rregullimi i rrugëve dhe ndriçimit në Shtime: Rr.Sefë Kosharja, Sami Frashëri, Enver Gashi, Sahide Metushi dhe Rivitalizimi i Rr.2 Korriku	9,271.45
4		20	480(48007)		Zhvillim Ekonomik	Subvencione dhe Transfere	12,600.00
5		20	755(75531)		Sherbimet Sociale	Subvencione dhe Transfere	10,000.00
6		20	850(85007)		Shërbimet kulturore	Subvencione dhe Transfere	12,800.00

7	20	470(47047)		Zhvillimi dhe Inspektimi Bujqësor	Subvencione dhe Transfere	40,000.00
8	13	920(94380)		Arsimi i Mesëm	Mallra dhe Sherbime	16,906.21
9	13	180(18451)		Menaxhimi i katastrofave natyrore	Mallra dhe Sherbime	80,000.00
10	13	920(93180)		Arsimi Fillor	Mallra dhe Sherbime	19,664.49
11	30	850(85007)		Shërbimet kulturore	Rregullimi i Stadionit në Lagjen e Pajtimit	25,000.00
12	30	920(93180)	56114	Arsimi Fillor	Rregullimi i sallave sportive të shkollave në Muzeqinë e Carralevë	18,254.77
13	13	730(73450)		Shëndetësia Primare	Mallra dhe Shërbime	11,963.01
					TOTAL:	266,448.06

II

A r s y e t i m: Në bazë të Propozimit për Ndarjen e të Hyrave të Bartura nga vitit 2024 në vitin 2025 janë bërë ndryshime (ritje) në strukturën e kategorive ekonomike si vijon:

- Në kategorinë e Mallrave dhe Shërbimeve kemi rritje prej 128,533.71 euro,
- Në kategorinë e Investimeve Kapitale kemi rritje prej 60,514.35 euro,
- Në kategorinë e Subvencioneve dhe Transfereve kemi rritje prej 77,400.00 euro.

E gjithë kjo rritje vjen si rezultat i tejkallimit të projeksionit të hyrave vetanake në shumën prej 194,636.27 euro. Shuma tjetër prej 26,560.77 euro janë mjete të pa shpenzuara nga fondi 21. Shuma prej 45,251.02 euro janë mjete të pa shpenzuara nga fondi 22. Në total shuma e mjeteve për bartje e THV nga viti 2024 në vitin 2025 është 266,448.06 euro.

- Në kategorinë e Mallrave dhe Shërbimeve janë planifikuar për mbulimin e shpenzimeve të nevojave të DSHP-së, marrveshje për Fondin e Eficiencës së Energjisë, dhe një pjesë janë mjete për QKMF-në të cilat janë arkëtuar më shumë se sa planifikimi i tyre që e kanë pas.
- Në kategorinë e Investimeve Kapitale janë planifikuar për përfundimin e dy projekteve të Drejtoria e Urbanizmit, një pjesë është për Stadionin e futbollit në Lagjen e Pajtimit – faza e parë, dhe pjesa tjetër është për rregullimin e sallave sportive të shkollave në fshatrat Muzeqinë dhe Carralevë.
- Në kategorinë e Subvencioneve dhe Transfereve janë planifikuar për përfundimin e katër marrveshjeve, dy të Drejtoria e Bujqësisë, një të Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenie Sociale, dhe një të Drejtoria e Inovacionit.

III

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e rexhistrimit në evidencën e protokolit zyrtar në MAPL, si dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb – faqen zyrtare të Komunës së Shtimes.

IV

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Drejtorive, Zyrës për Financa, Kryetarit të Komunës, Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, Ministrisë të Financave dhe Zyrës për Informim.



Kryesuesi i Kuvendit

Adnan Ademi